



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 374 / Prot.  
1

Tiranë, më 15 / 3 / 2017

VENDIM

Nr. 49 , datë 15 / 3 / 2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr. 374 Prot., datë 23.02.2017, kundër Autoritetit Publik "Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

Ankuesi nëpërmjet kërkesës për informim datë 17.01.2017 me nr.004/17 ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, vënien në dispozicion të informacionit si më poshtë:

- *Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim quajtur "KLSH") me nr.prot. 3 datë 03.01.2013 për veprën penale të fallsifikimit (neni 186 i Kodit Penal), ndaj punonjësit të KLSH?*
- *Kopje të vendimit të marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm.*
- *Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot. 3 datë 03.01.2013.*
- *A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë?*

Me shkresën nr. 80 Prot., datë 16.02.2017 Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kthyer përgjigje kërkuarit, duke e informuar lidhur me vendimmarrjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për kallëzimin e sipërpërmendur si dhe për komunikimin e këtij vendimi shtetasit të kallëzuar.

Pas mospërbushjes së pikave 2 dhe 3 të objektit të kërkesës për informim nga ana e Autoritetit Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ankuesi depozitoi pranë Komisionerit ankimin nr. 374 Prot datë 23.02.2017 duke i kërkuar këtij të fundit ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe konsultimi i legjislationit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" administrohet nga Autoriteti Publik/Prokuroria pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në kuadër të një kallëzimi penal të depozituar pranë kësaj prokurorie nga KLSH.

Rrjedhimisht në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” së bashku me kufizimet që ky ligj mund të përmbajë lidhur me publikimin e informacionit.

Gjithashtu duke pasur parasysh pikat 2 dhe 3 të objektit të kërkesës për informim, Autoriteti Publik, në bërjen publike të informacionit duhet të zbatojë kufizimet sipas nenit 17, pika 1 a) të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.,

Sa më sipër Autoriteti Publik duhet të bëjë publik informacionin në përputhje me nenin 17 pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion të kërkuarit. Personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të bëjnë anonimizimin e të dhënave në përputhje me nenet e sipërcituara.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica” me Nr. 374 Prot., datë 23.02.2017, ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në përputhje me nenin 17, pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” brenda datës 23. 3 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot me datë 15. 3 .2017.

